REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.74, datë 20/12/2005

"MBI DETYRIMET FINANCIARE TË BASHKISË SË TIRANËS NDAJ PERSONAVE TË TRETË QË LIDHEN ME VENDIME GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË"

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32, gërma "g" dhe "dh", Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.12, dt.21/03/2005 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2004 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2005", me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë listën dhe shumat përkatëse të detyrimeve financiare të Bashkisë së Tiranës, që lidhen me vendime gjyqësore të formës së prerë ndaj personave të tretë, sipas Tabelës Nr.1, pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

2. Të miratojë listën dhe shumat përkatëse të detyrimeve financiare të Drejtorise Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit, që lidhen me vendime gjyqësore të formës së prerë ndaj personave të tretë, sipas Tabelës Nr.2, pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

3. Efektet financiare prej 1.334.553 lekësh për pikën 1 të këtij Vendimi, përballohen nga zëri "Detyrime Gjyqësore" nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës për vitin 2005.

4. Efektet financiare për pikën 2, në shumën 294.770 lekësh, do të përballohen duke pakësuar zërin detyrime gjyqësore nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës duke shtuar në po këtë shumë, buxhetin e miratuar për vitin 2005 të Drejtorisë Nr.3 të Punëtorëve të Qytetit, në artikullin "Shpenzime Operative" për pagesë të detyrimeve gjyqësore.

5. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Administrimit Financiar, Drejtoria e Financës, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit.

6. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI